

# KONTRATË PËR HUANË

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, përkatësisht Nenit 567 të këtij Ligji, dhe në bazë të vullnetit të lirë të palëve, pa ndonjë ndikim çfarëdo qoftë ai, me datë \_\_\_\_\_ në Prishtinë, Republika e Kosovës, lidhet kjo Kontratë për Huanë në mes të palëve si në vijim:

**Huadhënësi:** \_\_\_\_\_ me numër unik identifikues \_\_\_\_\_, me adresë në rr. \_\_\_\_\_, përfaqësuar nga \_\_\_\_\_ me numër personal në letërnjoftim \_\_\_\_\_ ;

**Huadhënësi:** \_\_\_\_\_ me numër personal në letërnjoftim \_\_\_\_\_, me adresë në rr. \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, Republika e Kosovës;

**Huadhënësi:** \_\_\_\_\_ me numër personal në letërnjoftim \_\_\_\_\_, me adresë në rr. \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, Republika e Kosovës;

**Huamarrësi:** \_\_\_\_\_ me numër unik identifikues \_\_\_\_\_, me adresë në \_\_\_\_\_ Republika e Kosovës, përfaqësuar nga \_\_\_\_\_ me numër personal në letërnjoftim \_\_\_\_\_.

## 1. OBJEKTI DHE QËLLIMI I KONTRATËS

Qëllimi i kësaj kontrate është të përcaktojë kushtet sipas të cilave Huadhënësit pranojnë që të i japin Huamarrësit shumën hua prej 100,000.00EUR.

## 2. SHUMA E HUASË

2.1 Ashtu siç specifikon Neni 1 i kësaj kontrate, shuma e cila është subjekt i huasë ka vlerën ekuivalente prej 100.000.00EUR.

2.2 Huadhënësi \_\_\_\_\_ pranon që të i jap hua Huamarrësit në vlerë prej \_\_\_\_\_ EUR.

2.3 Huadhënësi \_\_\_\_\_ pranon që të i jap hua Huamarrësit në vlerë prej \_\_\_\_\_ EUR.

2.4 Huadhënësi \_\_\_\_\_ pranon që të i jap hua Huamarrësit në vlerë prej \_\_\_\_\_ EUR.

2.5 Mjetet nga huaja do të realizohen me transfer bankar, në llogarinë bankare të Huamarrësit me numër \_\_\_\_\_.

## 3. KUSHTET DHE AFATI I HUASË

3.1 Për huanë e dhënë, Huamarrësi pranon të ngarkohet me 4% interes vjetor. Interes i cili do të paguhet në baza mujore, ose sipas kërkesës së huadhënësit.

3.2 Huamarrësi pranon se do të kthejë huanë e marrë tek huadhënësit brenda afatit 2 (dy) vjeçar që nga data e pranimit të Huasë.

#### **4. TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E HUAMARRËSIT**

4.1 Huamarrësi është i obliguar që secilit Huadhënës të i'a kthejë huanë e marrë, së bashku me interesin.

4.2 Huamarrësi është i obliguar që të respektoj afatin kontraktues të kësaj kontrate, respektivisht të kthejë huanë jo më larg se 2 (dy) vjet nga data e pranimit të huasë.

4.3 Huamarrësi është i obliguar që të respektoj në tërësi këtë marrëveshje.

4.4 Në çdo kohë, përderisa kjo kontratë është në fuqi, nëse Huamarrësi siguron ndonjë hua tjetër (shembull: institucion financiar), Huamarrësi ka për detyrë që fillimisht të kryej obligimet e tij që dalin nga kjo kontratë.

4.5 Kthimi i Huasë tek vetëm një Huadhënës nuk do të ketë efektin e përmbushjes së kësaj kontrate. Huamarrësi duhet të kryejë obligimin e tij në mënyrë kumulative.

4.6 Nëse Huamarrësi bie në vonesë ndaj njërit Huadhënës, konsiderohet që është në vonesë edhe ndaj Huadhënësit tjetër, nëse ka.

4.7 Huamarrësi nuk ka të drejtë të që të transferoj detyrimet e tij tek ndonjë person i tretë, përveç nëse për këtë kanë dhënë pëlqimin Huadhënësit.

4.8 Huamarrësi ka të drejtë që të përmbushë detyrimin e tij, respektivisht të kthejë huanë edhe para afatit kontraktual të kësaj kontrate.

4.9 Huamarrësi pranon që, me qëllim të realizimit të kërkesave ndaj Huadhënësve, kjo kontratë të jetë subjekt i përbarimit sipas ligjeve në fuqi.

#### **5. TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E HUADHËNËSVE**

5.1 Huadhënësit kanë për detyrë që të japin huanë tek Huamarrësi ashtu siç është kontraktuar në këtë kontratë.

5.2 Huadhënësit kanë të drejtë që të kërkojnë kthimin e huasë ashtu siç përcakton paragrafi 2 i nenit 3.

5.3 Në rast se kërkohet pëlqim nga Huadhënësit prej Huamarrësit për cedimin e kërkesave të këtij të këtij të fundit, Huadhënësit kanë të drejtë që të mos e japin një pëlqim të tillë.

5.4 Huadhënësit, në rast të vonesës së kthimit të huasë, por jo më larg se 10 ditë vonese, kanë të drejtë të kërkojnë sigurimin e huasë së tyre ashtu siç është përcaktuar me Nenin 6 të kësaj kontrate.

5.5 Huadhënësit kanë të drejtë që për çdo dështim eventual të përmbushjes së detyrimeve nga ana e Huamarrësit, të iniciojnë procedurë përbarimore.

## **6. KUSHTI I VEÇANTË PËR SIGURIMIN E KËSAJ KONTRATE**

- 6.1 Në çdo rast kur, Huamarrësi dështon të veproj përshtatshmërisht me nenet 3 dhe 4 të kësaj kontrate, atëherë Huamarrësi pajtohet që të drejtat pronësore sipas ngastrës kadastrale P-71914034-01095-6 dhe P-71914034-01095-7 në zonën kadastrale Kolovicë, e njohur si Lagja e Gjelbër, në Prishtinë të u'a transferoj Huadhënësve, pa kushtëzime dhe pa vonesë, sipas marrëveshjes për hipotekën, me bazë ligjore Ligji nr. 2002/4 – Ligji për Hipotekat.
- 6.2 Huamarrësi pranon që afati kontraktual i kësaj kontrate nuk mund zgjatet. Huamarrësi po ashtu pajtohet që për Huanë e marrë, në rast të vonesës së kthimi të saj, të drejtat pronësore, pronë kjo që identifikohet përmes ngastrës kadastrale P-71914034-01095-6 dhe P-71914034-01095-6 do të kalojnë tek Huadhënësit sipas paragrafit 1 të këtij Neni, proporcionalisht me shumën e huasë që ata e kanë dhënë.
- 6.3 Raporti i vlerësimit të pronës, së bashku me çfarëdo dokumenti tjetër për identifikimin e kësaj prone, do të jenë pjesë e kësaj kontrate në formë të shtojcave.
- 6.4 Huamarrësi zotohet se është pronari i vetëm dhe ekskluziv i paluajtshmërisë të lartpërmendur në këtë nen.
- 6.5 Huamarrësi zotohet dhe garanton se pronën e paluajtshme e identifikuar si më lartë nuk do e shes, jap me qira, bartë apo disponoj me të në një mënyrë tjetër, dhe nuk do të konstituj kurrëfarë barre mbi të njëjtën gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate, dhe deri në kthimin total të huasë.

## **7. MARRËVESHJA NDËRMJET HUADHËNËSVE**

- 7.1 Huadhënësit pajtohen që në çdo rast kur, Huamarrësi dështon të veproj përshtatshmërisht me paragrafet e Nenit 4 të kësaj Kontrate, përkatësisht nuk kryen detyrimin e tij për pagesën e Huasë që ka marrë, atëherë do e kompensojnë njëri-tjetrin në shumën në të cilën Huadhënësi ka dhënë Huanë.
- 7.2 Me kompensimin e kësaj shume, Huadhënësi i kompensuar pajtohet që e drejta e tij që rrjedhë nga kjo kontratë është realizuar, dhe heq dorë nga e drejta e pronës e specifikuar në Nenin 6 të kësaj marrëveshje.
- 7.3 Huamarrësit pajtohen mes vete që, në rast se Huadhënësi dështon në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë, atëherë të drejtën për kompensimin e Huadhënësit tjetër e ka Huadhënësi huaja e të cilit përbën shumën më të madhe monetare. Në rast se kjo e drejtë nuk realizohet nga Huadhënësi huaja e të cilit përbën shumën më të madhe, atëherë Huadhënësi tjetër do ta realizoj këtë të drejtë në raport me Huadhënësin tjetër.

7.4 Huadhënësi i cili do e realizoj të drejtën e tij sipas paragrafit 3 të këtij Neni, ka për detyrë që brenda afatit 10 (dhjetë) ditë prej momentit që Huamarrësi është në vonesë, t'a kompensoj Huadhënësin tjetër në proporcion me shumën që ka kontribuar në hua.

7.5 Huadhënësi që kompensohet sipas këtij neni, pajtohet që e drejta e tij monetare është realizuar, dhe heq dorë nga e drejta e specifikuar në Nenin 6 të kësaj Kontrate.

7.6 Huadhënësi që ka kompensuar Huadhënësin tjetër, do të gëzojë të drejtën në tërësi (100%) të pronës të specifikuar në Nenin 6.

## **8. TËRËSIA E KONTRATËS**

8.1 Kjo Kontratë së bashku me kushtet, afatet dhe Shtojcat e saj do të interpretohet si një e tërë.

8.2 Në rast se ndonjë nen i kësaj kontrate krijon paqartësi, atëherë kuptimi i tij duhet të shikohet në kontekstin e tërë Kontratës dhe sipas qëllimit për të cilën palët e kanë lidhur këtë kontratë.

## **9. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

9.1 Çdo ndryshim i kësaj Kontrate do të bëhet me shkrim, në formë të Shtojcave.

9.2 Kjo Kontratë rregullohet dhe interpretohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Kosovës.

9.3 Çdo mosmarrëveshje eventuale ndërmjet palëve do të provohet të zgjidhet me mirëkuptim, në të kundërtën palët do ti drejtohen zgjidhje Gjykatës Themelore në Prishtinë.

9.4 Kjo Kontratë është hartuar në 6 (gjashtë kopje), nga dy për secilën palë.

9.5 Palët pajtohen që kjo kontratë të vërtetohet tek ndonjë Noter i Republikës së Kosovës.

9.6 Kjo Kontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga palët.

Huadhënësi: \_\_\_\_\_

Huadhënësi: \_\_\_\_\_

Huamarrësi: \_\_\_\_\_